



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 973/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike, Sh.A., me numër unik identifikues 810799364 dhe seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, nr. 5, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “S...” Sh.A., me numër unik identifikues dhe seli në Prishtinë, rr. “...”, nr. ..., të cilën e përfaqëson kompania e avokatëve “A...” në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1538/2020, i lejuar me datë 28.12.2020, nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 15.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “S...” Sh.A., me numër unik identifikues, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1538/2020, i lejuar me datë 28.12.2020, nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 1538/2020, i lejuar me datë 28.12.2020, nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, MBETET në fuqi

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike, Sh.A., në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Ekonomike, Ek.nr.347/2018, të

datës 28.06.2019, pjesërisht i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae.nr.313/19, të datës 13.07.2020, i ekzekutueshëm me datë 16.09.2020, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 1538/2020, të datës 28.12.2020, me të cilin ka urdhëruar debitorin Kompania e Sigurimeve "S..." Sh.A., që në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 27,360.00, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, data 13.07.2020, e tutje deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej EUR 400.00, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor me arsyetim se aktgjykimet mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri janë paraqitur nga kreditori në kopje, ndërsa gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin dhe urdhri përmbarrimor të anulohet.

Kreditori, ka theksuar se prapësimi i paraqitur nga debitori është i pabazuar dhe i paargumentuar me asnjë provë duke theksuar se dokumenti përmbarrimor është dorëzuar në origjinal, ndërsa gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas dokumentit përmbarrues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Ekonomike, Ek.nr.347/2018, të datës 28.06.2019, pjesërisht i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae.nr.313/19, të datës 13.07.2020, i ekzekutueshëm me datë 16.09.2020, rrjedh se debitori është i detyruar që kreditorit t'ia paguaj në emër të pasurimit pa bazë shumën në lartësi prej EUR 27,360.00, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 20.06.2018 e tutje deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej EUR 400.00.

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht, aktgjykimin mbi bazën e të cili është lejuar përmbarimi dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues mbi bazën e të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu, ky aktgjykim, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit se aktgjykimet në propozim për përmbarim janë paraqitur në kopje nga ana e kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara ngase dokumenti përmbarimor mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor është dorëzuar në origjinal, dhe i njëjti mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 16.09.2020, rrjedhimisht i plotëson kushtet sipas nenit 36, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri.*

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore nga neni 71 i LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.973/22, dt. 15.03.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes kësaj Dhome.